



## **Kërkesë për oferta për shërbimet e prodhimit të videove për aktivitete promovuese dhe mbulim eventesh.**

### **Titulli i projektit: Empowerment to youth and vulnerable groups with counselling process using ProfilPASS Instrument and Social Coaching**

Nga hulumtimi i tregut për kompanitë potenciale në Kosovë, ftojmë kompaninë tuaj që të bëjë ofertë për shërbimet e mëposhtme.

Kompanitë që janë të interesuara ju lutemi të plotësoni dokumentin e mëposhtëm dhe të mos përdorni modele të tjera.

Ofertat duhet të dorëzohen me email; kopje të skenuara pastër.

Kompania që do të fitojë kontratën do të duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme;

- ❖ Certifikatë regjistrimi
- ❖ Detajet bankare/pasqyra nga banka
- ❖ Profili i kompanisë dhe referencat

Thirrja do të jetë e hapur nga data: 09/12/2024 deri më datë: 15/12/2024 në ora: 16:00.  
Ofertat dorëzohen në email: [oferta.eycd@gmail.com](mailto:oferta.eycd@gmail.com)

Autoriteti kontraktues

Environment & Youth Capacity Development

Afërdita Shala, Kordinatore e projektit

Adresa: Rruga "William Walker", Prizren - Kosovë

Tel: +383 44 816-504

[ngo.eycd@gmail.com](mailto:ngo.eycd@gmail.com), <https://eycd.net/>



## SHTOJCA I: TERMAT E REFERENCAVE

### SHËRBIMET E PRODHIMIT TË VIDEOVE PËR AKTIVITETE PROMOVUESE DHE MBULIM EVENTESH

Autoriteti kontraktues: Mjedisi dhe Zhvillimi i Kapaciteteve Rinore

Adresa: Rruga “William Walker”, Prizren – Kosovë, Tel: +383 44 816-504

ngo.eycd@gmail.com, <https://eycd.net/>

Emri i projektit: Empowerment to youth and vulnerable groups with the counselling process using ProfilPASS Instrument and Social Coaching

1. INFORMACIONI BAZË.....	3
1.1. Autoriteti Kontraktor .....	3
2. OBJEKTIVI, QËLLIMI & REZULTATET E PRITSHME.....	3
2.1. Objektivi i përgjithshëm.....	3
3. SUPOZIMET DHE RREZIQET.....	3
3.1. Supozimet në bazë të ndërhyrjes së projektit.....	3
4. FUSHA E PUNËS .....	4
4.1. Të përgjithshme .....	4
4.1.1. Përshkrimi i detyrës .....	4
4.1.2 Aktivitete specifike .....	4
4.2. Menaxhimi i projektit .....	5
5. LOGJISTIKA DHE KOHA .....	5
5.1. Data e fillimit & Periudha e zbatimit të detyrave .....	5
5.2 Koha e reagimit të mobilizimit .....	5
6. KËRKESAT.....	6
6.1. Personeli.....	6
6.2. Akomodimi në zyrë: .....	6
6.3. Lehtësirat që do të ofrohen nga kontraktori: .....	6
6.4. Pajisjet.....	6
6.5. Sigurimi: .....	6



7. KËRKESAT E RAPORTIMIT DHE FATURIMI .....	7
7.1. Bugjeti:.....	8

## 1. INFORMACIONI BAZË

### 1.1. Autoriteti Kontraktor

OJQ “Mjedisi dhe Zhvillimi i Kapaciteteve Rinore”

## 2. OBJEKTIVI, QËLLIMI & REZULTATET E PRITSHME

### 2.1. Objektiv i përgjithshëm

Loti 1: Video Produksioni

Të sigurohen shërbime profesionale për prodhimin e 8 videove të shkurtra, të përkthyera dhe përshtatura në tre gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht), në pajtim me Termat e Referencës për shërbimin e kërkuar. Këto video do të përdoren për të prezantuar punën e projektit dhe për të mbështetur institucionet përfituese, duke rritur ndërgjegjësimin dhe promovimin e aktiviteteve dhe rezultateve të projektit.

Loti 2: Mbulimi i Eventeve (Event Coverage)

Të sigurohen shërbime të dokumentimit dhe krijimit të materialeve vizuale, përfshirë fotografi dhe infografikë, gjatë aktiviteteve të projektit, në pajtim me Termat e Referencës për shërbimin e kërkuar. Materialet vizuale do të përdoren për dokumentimin e eventeve dhe promovimin e projektit në rrjetet sociale dhe platformat digjitale, duke rritur dukshmërinë dhe ndikimin e tij.

## 3. SUPOZIMET DHE RREZIQET

### 3.1. Supozimet në bazë të ndërhyrjes së projektit

N/A



## 4. FUSHA E PUNËS

### 4.1. Të përgjithshme

#### 4.1.1. Përshkrimi i detyrës

##### Loti 1: Video Produksioni

Kontraktori do të jetë përgjegjës për prodhimin e 8 videove të shkurtra në tre gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht), duke bashkëpunuar ngushtë me koordinatorin/en e OJQ-së për të siguruar që videot të përmbushin qëllimet dhe kërkesat e projektit.

##### Loti 2: Mbulimi i Eventeve (Event Coverage)

##### Përshkrimi i detyrës

Kontraktori do të jetë përgjegjës për dokumentimin vizual të aktiviteteve të projektit, përmes fotografive dhe infografikëve, duke siguruar material të cilësisë së lartë në koordinim me koordinatorin/en e OJQ-së dhe në përputhje me Termat e Referencës.

#### 4.1.2 Aktivitete specifike

##### Loti 1: Video Produksioni

- Prodhimi i 8 videove të shkurtra në tre gjuhë, me përmbajtje të përshtatur për rrjete sociale dhe promovim.
- Montimi i videove dhe përshtatja e tyre sipas udhëzimeve të projektit.
- Realizimi i inçizimeve në terren për mbledhjen e materialeve vizuale cilësore.
- Përdorimi i teknologjisë së avancuar për prodhimin dhe përpunimin e materialeve.

##### Loti 2: Mbulimi i Eventeve (Event Coverage)

- Realizimi i fotografive profesionale gjatë aktiviteteve të projektit për qëllime dokumentimi dhe promovimi.
- Krijimi i infografikëve të dizajnuar posaçërisht për rrjete sociale dhe uebfaqen e projektit.
- Përdorimi i teknologjive të reja për dokumentimin e aktiviteteve me cilësi të lartë.
- Dorëzimi i materialeve vizuale të përgatitura sipas udhëzimeve të projektit brenda afateve të përcaktuara.



## 4.2. Menaxhimi i projektit

Menaxhimi i projektit do të bëhet nga kordinatori/ja i/e projektit ose zëvendësi i tij/saj i deleguar.

## 5. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 5.1. Data e fillimit & Periudha e zbatimit të detyrave

#### Loti 1: Video Produksioni

Data e fillimit të zbatimit do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të detyrave të identifikuar është 8 muaj nga data e fillimit.

#### Loti 2: Mbulimi i Eventeve (Event Coverage)

Data e fillimit të zbatimit do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të detyrave të identifikuar është 55 ditë.

### 5.2 Koha e reagimit të mobilizimit

#### Loti 1: Video Produksioni

Ekipi i projektit do të dorëzojë Urdhëresën e Shërbimit tek kontraktori i cili do të ofrojë në kohë reale shërbimet e tyre. Në raste të veçanta urgjente/ad hoc siç është realizimi i ndonjë video në ndonjë lokacion të ri të pamenduar më parë, kontraktori duhet të veprojë menjëherë dhe të ndërlidhet me kordinatorin/en dhe ofruesin e domenit në koordinim të ngushtë me menaxherin e projektit.

#### Loti 2: Mbulimi i Eventeve (Event Coverage)

Ekipi i projektit do të dorëzojë Urdhëresën e Shërbimit tek kontraktori, i cili duhet të ofrojë shërbimet në kohë reale sipas kërkesave të projektit. Në raste të veçanta urgjente/ad hoc, siç është dokumentimi i ndonjë eventit të ri apo i paplanifikuar, kontraktori duhet të veprojë menjëherë dhe të ndërlidhet me kordinatorin/en dhe ofruesin e shërbimeve, duke bashkëpunuar ngushtë me menaxherin e projektit.



## 6. KËRKESAT

### 6.1. Personeli

Kontraktuesi duhet të caktojë një menaxher të kontratës i cili është pika kryesore e kontaktit për Autoritetin Kontraktor.

Menaxheri i kontratës duhet të jetë përgjegjës për marrjen e Urdhëresës së Shërbimit dhe sigurimin e zbatimit të Urdhëresës për Shërbimin brenda afatit të paraparë siç është specifikuar në 5.2. Ky person është gjithashtu përgjegjës për dorëzimin e raportit të shërbimit tek Autoriteti Kontraktor.

Menaxheri i kontratës duhet të dorëzojë një CV ku do të theksojë përgatitjen profesionale dhe përvojën e tij në këtë fushë.

CV-ja e menaxherit të propozuar të kontratës duhet të dorëzohet si pjesë e dokumentacionit të dosjes së thirrjes pasi do të shërbejë si bazë për vlerësimin teknik.

Menaxheri i kontratës duhet të përmbushë kërkesat minimale të mëposhtme:

- Minimumi arsimor është Diplomë Universitare në Teknologji Informative, Shkenca Kompjuterike ose disiplina të ngjashme;
- Së paku tre vjet përvojë pune si operator

### 6.2. Akomodimi në zyrë:

N/A

### 6.3. Lehtësirat që do të ofrohen nga kontraktori:

N/A

### 6.4. Pajisjet

Asnjë pajisje nuk duhet të blihet në emër të Autoritetit Kontraktor si pjesë e kësaj kontrate shërbimi ose t'i transferohet Autoritetit Kontraktues në fund të kësaj kontrate.

### 6.5. Sigurimi:

N/A



## 7. KËRKESAT E RAPORTIMIT DHE FATURIMI

### Loti 1: Video Produksioni

- Realizon 8 video të shkurtra në tre gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht).
- Montazon dhe i përgjigjet kërkesave për përpunimin e videove në bazë të kërkesave të projektit.
- Realizon inqizimin në terren për mbledhjen e materialeve vizuale cilësore.
- Përdor teknologji të re apo të avancuar për prodhimin dhe përpunimin e videove.

#### Dorëzimi i Raporteve:

Raporti dorëzohet jo më vonë se dy javë pas ekzekutimit të “Urdhrit të Shërbimit”. Ai i dorëzohet koordinatorit/es të projektit. Pas ekzekutimit të “Urdhrit të Shërbimit”, kontraktori do t'i sjellë Autoritetit Kontraktor faturën që korrespondon me detyrat e kërkuara si pjesë e Urdhrit të Shërbimit.

Raporti përbëhet nga një seksion narrativ dhe një seksion financiar. Seksioni financiar duhet të përmbajë detaje të shërbimeve të ofruara, në veçanti datat dhe çmimet aktuale sipas kontratës dhe/ose "Urdhrit të Shërbimit".

### Loti 2: Mbulimi i Eventeve (Event Coverage)

- Realizon fotografi profesionale gjatë aktiviteteve të projektit.
- Krijon infografikë për rrjete sociale dhe uebfaqe, bazuar në kërkesat e projektit.
- Përdor teknologji të avancuar për dokumentimin dhe përpunimin e materialeve vizuale.

#### Dorëzimi i Raporteve:

Raporti dorëzohet jo më vonë se dy javë pas ekzekutimit të “Urdhrit të Shërbimit”. Ai i dorëzohet koordinatorit/es të projektit. Pas ekzekutimit të “Urdhrit të Shërbimit”, kontraktori do t'i sjellë Autoritetit Kontraktor faturën që korrespondon me detyrat e kërkuara si pjesë e Urdhrit të Shërbimit.

Raporti përbëhet nga një seksion narrativ dhe një seksion financiar. Seksioni financiar duhet të përmbajë detaje të shërbimeve të ofruara, në veçanti datat dhe çmimet aktuale sipas kontratës dhe/ose "Urdhrit të Shërbimit".



## 7.1. Bugjeti:

A	B	C	D	E
Artikulli	Përshkrimi	Sasia/ muaj	Çmimi për njësi	Totali
1.1	Video për historit e suksesit te pjesëmarrësit Video duhet te jene ne 3 gjuhe	4 video		
1.2	Video për histori suksesti të këshilltarëve Video duhet te jene ne 3 gjuhe	4 video		
1.3	Fotografi për aktivitetet e projektit Krijimi i infografikeve Dizajn fotografive per rrjete sociale	55 ditë		
<b>Totali:</b> _____				